

DEGA AUTO-MEKANIKE

1. Vizatim Teknik / Autocad 10

Lënda e Vizatimit Teknik dhe AutoCAD-it jepet me metodat më sociale të përfytyrimit të formave të sendeve apo objekteve të ndryshme të natyrës. Vizatimi bëhet me ose pa vegla të vizatimit teknik, me dorë të lirë në formën e skicës, e cila shërben për bërjen e shpejtë të paraqitjes grafike të sendit apo objektit natyror. Nëse bëhet me vegla, ajo mer formën e vizatimit të punës. Në të dyja rastet, kemi të bëjmë me paraqitjen e objekteve të ndryshëm me përmasat e dhëna të gatshme për tu prodhuar ose e anasjellta, kur vizatimi është i bërë, nxënësi të jetë në gjendje ta lexojnë atë, për të krijuar idenë dhe përfytyrimin rreth objektit të paraqitur. Në AutoCAD nxënësit mësojnë kryesisht se si bëhet e mundur realizimi i vizatimit të objekteve të ndryshëm natyror nëpërmjet kompjuterit në 2D (në plan) dhe 3D (në hapësirë). Këto realizohen nëpërmjet mësimit të komandave kryesore të AutoCAD-it si dhe përfytyrimit të objekteve në hapësirë. Këto mbështeten tek praktika ku vazhdimisht bëhen ushtrime të ndryshme nga më të thjeshtat deri tek më të vështirat si nga pamjet deri tek vizatimet përmbledhëse etj.

2. Ekonomi - Hyrje në Biznes 10

Nëpërmjet kësaj lëndë nxënësit pajisen me njohuritë kryesore në fushën e biznesit duke filluar me rolet ekonomike që luan çdo individ në jetën e përditshme (roli si konsumator, si punonjës dhe si qytetar për krijimin e të mirës së përgjithshme). Në këtë lëndë trajtohen githashtu rrugët më të efektshme për administrimin e të ardhurave dhe kursimeve me rrezik sa më të ulët dhe fitim sa më të lartë, mbrojtje me anë të sigurimit kundrejt humbjeve ekonomike, si vepron ky sigurim dhe pse ai është i nevojshëm.

Nxenesit marrin njohuri për zhvillimin e tregtisë së jashtme dhe asaj të brendshme funksionet e bankave, inflacionin, deflacionin, rolin ekonomik të shtetit dhe funksionet e tij

3. TIK-Aplikim në kompjuter 12, 13

Aplikime kompjuterike 12

Në këtë kurikul nxënësit mësojnë dy programe kompjuterike: RhinoAutoCAD dhe 3D-Max. Programi Rinoceront (zakonisht i shkurtuar Rhino, ose Rhino3D) është një program kompjuterik grafikor 3D, i cili u vjen në ndihmë nxënësve për të realizuar vizatime të ndryshme me ndihmën e kompjuterit, kompjuter-Aided(CAD). Gjeometria Rinoceront është bazuar në modelin matematikor NURBS, e cila fokusohet në prodhimin dhe përfaqësimin matematikisht të saktë të kthesave dhe sipërfaqeve të realizuara me freeform në kompjuter.

Programi Rinoceront është përdorur në proceset kompjuterike - kompjuter Aided Design (CAD), në prodhimin e objekteve me ndihmën e programit CAD-CAM, prodhimin e prototipeve të shpejtë 3D në vizatimet industriale përfshirë vizatimet e arkitekturës, dizajnit industrial (p.sh. dizajni i automobilave, dizajnet ujore), të projektimit të produktit (p.sh. dizajn bizhuteri), si dhe për multimedia dhe dizajn grafik. Programi 3D-Max është një mjet i fuqishëm modelimi në 3D. Me anë të këtij programi nxënësit do të mësojnë konceptet bazë të cilat lejojnë dizenjuesit dhe planifikuesit të komunikojnë konceptet komplekse 3D. Me anë të komandave të specializuara të programit nxënësit do të mësojnë të modelojnë forma organike dhe të simulojnë zhvendosje filmike. Do të mësojnë të importojnë modele në aplikacione të tjera si psh AutoCAD dhe t'i eksportojnë ato në 3D-Max.

Aplikime kompjuterike 13

Në këtë kurikul nxënësit mësojnë programin kompjuterik Sketchup. Programi Sketchup është një mjet i fuqishëm modelimi në 3D. Me anë të këtij program nxënësit do të mësojnë konceptet bazë të cilat lejojnë dizenjuesit dhe planifikuesit të komunikojnë konceptet komplekse 3D. Me anë të komandave të specializuara të programit nxënësit do të mësojnë të modelojnë forma organike dhe të simulojnë zhvendosje filmike. Do të mësojnë të importojnë modele nga aplikacione të tjera dhe t'i eksportojnë modelet SketchUp në programe të tjera 2D, 3D (si AutoCAD,3D-Max etj) si edhe në aplikacione filmike. Teknologji mekanike 12, 13

4. Mekanikë teknike 11

Elementët e Mekanikës në klasën e 11-të i pajisin nxënësit me njohuri mbi ligjet bazë të mekanikës, vazhdojnë me Epjen, trajtojnë llogaritjen e detaleve të makinave si dhe llojet e lidhjeve në to : a) lidhjet e paçmontueshme; b) lidhjet e çmontueshme. Gjithashtu njihen me transmisionin me fërkim, me rripa, me zinxhir, me rrota me dhëmbë etj. Në përfundim të programit nxënësit janë të aftë të kuptojnë parimin e punës dhe funksionimin e çdo lloj mekanizmi që përdoret sot në fusha të ndryshme.

5. Elemente te Elektroteknikes 11

Lenda Elemente te elektronikës është një nga lëndet formuese të degës së automobilave. Në të studiohen konceptet bazë të madhësive elektrike, ligjet që veprojnë në qarqet elektrike, elementet e qarqeve elektrike të rrymes së vazhduar dhe alternative sinusoidale. Konceptet bazë të fushës magnetike si edhe ligjet e induksionit magnetik. Në bazë të tyre trajtohen parimet e punës së makinave elektrike, motore, gjeneratore e transformatore. Me tej

trajtohen njohurite mbi elementet elektronike si dioda, tranzistori e tiristori si pjese perberese te skemave elektronike te drejtimit dhe komandimit ne automobile.

Kapitulli I fundit trajton elementet fillesatare te teknikes digitale, kalimi I nje numri nga nje system numerimi ne nje tjetër, ndertimi i portave logjike dhe perdorimi I tyre, skemat logjike. Po ashtu edhe element e tjere, si kujtesat, regjistrat, numratorët, konvertuesit etj. Per ti bere me te qarta dukurite jane futur projekte, te cilat ndihmojne edhe ne bashkepunimin midis nxenesve, ne kerkimin dhe perzgjedhjen e materialeve etj.

6. Teknologji mekanike 12,13

Teknologji mekanike 12

Njohja me teknologjine mekanike dhe rolin e saj ne ekonomine e nje vendi, fushat e proceseve te prodhimit mekanik dhe industrial, lidhja e burimeve natyrore te lendeve te para dhe te materialeve te tjera te perdorimit industrial dhe bujqesor, njohuri mbi klasifikimin e metaleve, klasifikimin e menyrave te perpunimit te materialeve ne industrine mekanike, etj.

Njohja se si duhet te shfrytezohen mineralet, thelbin e proceseve metalurgjike, njohjen me prodhimin e gizes dhe celikut, ku bazohet, thelbi I proceseve metalurgjike te prodhimit te celikut, vecorite e prodhimit te celikut ne konvertore, elementet lidhes dhe si ndikojne ato, etj.

Njohja me ndarjen e materialeve metalike ne varesi te vetive te ndryshme qe kane, vetite fizike dhe kimike, vetite mekanike dhe vetite teknologjike, studimi dhe vleresimi i vetive mekanike dhe teknologjike me anen e provave te ndryshme, tipet e ndryshme te provave qe perdoren, etj.

Njohjen me perdorimin e materialeve metalike dhe ndryshimin e vetive te tyre ne varesi te ndryshimit te perberjes kimike, si kryhet procesi I kalimit te metaleve nga gjendja e lenget ne gjendje te ngurte apo kristalore, elementet qe ndikojne, temperature dhe shpejtesia e ftohjes, ndryshimi I rretave kristalore, pikat kritike te diagrames hekur karbon, ndryshimin e vetive te materialeve metalike si pasoje e perpunimeve termike qe kryhen ne to, cfare eshte pjekja dhe normalizimi, cfare eshte cimentimi, azotimi,defektet e ndryshme qe mund te ndodhin, etj.

Teknologji mekanike 13

Kjo lende shërben për krijimin e njohurive dhe shkathtësive profesionale të nxënësve sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare profesionale, me synim përgatitjen e tyre për tregun e punës. Teknologjia Mekanike i ndihmon nxënësit që të vendosin një marrëdhënie konkrete dhe të drejtpërdrejtë me karakter profesional, si dhe të thellohen më shumë në natyrën e profesioneve të cilat i "prek" kjo lende, të tilla si profesioni i Mekatronikut, Metalpunuesit, Mekanikut të makinave, Operatorit të makinave me dirigjim kompjuterik CNC, Instaluesit të ngrohjes dhe klimatizimit, Automekanikut dhe Autoelektricitit.

Vete Teknologjia Mekanike është relativisht e lidhur me format dhe menyrën e prodhimit të materialit duke filluar që nga lenda e parë.

Prodhimi dhe përpunimi i materialeve janë mjaft të rëndësishme dhe gjithashtu i japin një vlerë më tepër njohurive të marra nga nxënësi në fushën profesionale.

7. Impiantet e ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit 12, 13

Kjo lëndë është një kompleks disiplinash që merret me studimin e impianteve ftohëse dhe ngrohëse që përdoren në jetën e përditëshme. Duke shfrytëzuar vetitë e gazeve ftohëse bëhet e mundur realizimi i ftohjes artificiale. Kjo ka gjetur një përdorim të gjerë pothuajse në të gjitha industritë si: mekanike, kimike, ushqimore dhe për përdorim shtëpiak etj. Çdo ditë e më shumë po gjen përdorim teknika e ftohjes duke plotësuar nevojat në rritje të shoqërisë. Si lëndë zhvillohet në klasat 12-të dhe 13-të. Në klasën e 12-të nxënësit marrin njohuri për: bazat e ftohjes ku përfshihen gazet, transmetimin e nxehtësisë, skemat e ftohjes dhe elementët përbërës të tyre. Bëhet shoqërimi i këtyre njohurive me softet përkatëse. Në klasën e 13-të nxënësit marrin njohuri për elementë të ndryshëm të shërbimit dhe riparimit të sistemeve të ftohjes siç janë: evakuimi i sistemeve ftohëse, ngarkimi i sistemeve ftohëse, sistemet e ajrit të kondicionuar, sistemi i ventilimit etj. Këto shoqërohen me skemat përkatëse dhe softet.

8. Ndërtimi, përshkrimi dhe shërbimi i automobilave 11, 12, 13

Nëpërmjet kësaj lënde të specialitetit, nxënësit fitojnë njohuri të plota dhe të thella për tipet e ndryshme të motorave me djegie të brendshme si: karburator, me injeksion dhe diesel pa përjashtuar dhe motorat e të ardhmes dhe turbomotorat. Gjithashtu fitojnë njohuri të plota për ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmave dhe sistemeve të motorit, transmetimit të fuqive dhe pjesëve lëvizëse të tij. Për të gjitha këto mekanizma dhe sisteme, jepen

njohuri të hollësishme për mënyrat e kontrollit të punës normale të tyre në motora, sipas metodave më të sofistikuar elektronike që përdoren sot në automjetet moderne. Lënda jep njohuri të plota për shërbim-riparimin e agregateve të një automjeti, të mekanizmave të motorit dhe sistemeve të tij duke parashikuar të gjithë regjistrimet dhe kontrollet e nevojshëm. Nëpërmjet këtyre njohurive nxënësit njihen me veglat e punës, pajisjet dhe instrumentat matës dhe diagnostikues që mund të përdoren në një servis bashkëkohor.

Nxenesit gjate vitit te 12 njihen gjithashtu dhe me makinat elektrike dhe hybride, anen konstruktive te tyre, menyren e funksionimit dhe sherbimet qe kryen ne to.

9. Kontrolli dhe diagnostikimi i automobilave 13

Ndërtimi i kësaj lënde përfshin specialitetin e transportit automobilistik, për faktin se ajo kërkon një njohje të saktë të ndërtimit dhe funksionimit të automjeteve të sotëm modernë dhe njohuritë e plota për shërbimin dhe riparimin që i kërkohet atyre. Synimi i lëndës është që nxënësi të bëhet specialist duke gjetur dhe interpretuar të gjitha llojet e difekteve që ndodhin në automjet ne pjeset elektrike dhe elektronike te tij. Lënda ka për qëllim që t'i mësojë nxënësit ose specialistit përdorimin e të gjitha aparateve matese dhe testuese te nevojshme për të zgjidhur problemet kryesore të diagnostikimit të automobilave. Lënda parashikon përdorimin e aparateve të veçantë për probleme të caktuara dhe programeve diagnostikues si: gazoanalizatori, kompjuteri me anën e të cilëve bëhet një analizë e saktë për të nxjerrë diagnozën e vërtetë të difekteve që shfaqen.

10. Njohuri per transportin ajror 11, 12

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit pajisen me njohuri në: Aeronautikë dhe Aerodinamikë. Gjithashtu ata marrin njohuri për aeroplanin, lindjen e transportit ajror, infrastrukturën ligjore dhe organizative në transportin ajror si dhe prirjet aktuale të zhvillimit në transportin ajror.

Ne vitin e 11 trajtohen tema qe perfshijne ne menyre sintetike thelbin dhe arritjet e industrise se Transportit Ajror ne rrafsh global si dhe sfidat aktuale te kesaj veprimtarie shume dinamike te njerezimit.

Gjithashtu jepen parimet themelore te aerodinamikes mbi bazen e se ciles u be e mundur zbulimi I mekanizmit te krijimit te forces ngritese, etj.

Ne vitin e 13 na jepen infrastruktura ligjore dhe organizative e transportit ajror, konventat nderkombetare, sherbimet dhe fenomenet e zhvillimit te transportit ajror si dhe objektivat strategjike dhe e ardhmja e saj.

11. Strukturim administrim servisi

Nepermjet kesaj lende na jepet rruga e menaxhimit te nje servisi, duke shfrytezuar aftesite profesionale te fituara ne lendet e ndryshme profesionale te fushes automotive.

Nepermjet lendes sakesohet qe, per te qene nje menaxher I mire servisi duhet te kesh aftesite e duhura mbi sherbimin dhe riparimin e motorreve, sistemeve te ndryshme te automobilit.

Nepermjet kesaj lende gjithashtu na tregohet menyra e organizimit, organograma dhe drejtimi I nje servisi te autorizuar, merren njohurite lidhur me departamentet e tjera te nevojshem ne nje servis dhe bashkepunimi I ngushte midis tyre.

12. Praktikë profesionale 12, 13

Praktikë profesionale (Torneri-Axhusteri dhe Auto-Mekanikë) 12

Ndërtimi i kësaj lënde përfshin synimet kryesore të specialitetit të transportit automobilistik, sepse kërkon një njohje të saktë të ndërtimit dhe funksionimit të automjeteve të sotëm dhe njohuritë të plota për shërbimin dhe riparimin që u kërkohet atyre. Synimi kryesor i lëndës është që nxënësi të përgatitet si specialist në fushën e shërbimit dhe riparimit të automobilave, të marrë njohuri bazë për makinat metalprerëse (torneri) dhe axhusteri. Në makinat metalprerëse synohet që nxënësi të njohë mirë makinat tornuese, ndërtimin e tyre dhe llojet e punimeve që bëhen me to. Në axhusteri synohet që nxënësi të njohë dhe të përdorë instrumentet matës, veglat e axhusterisë dhe llojet e punimeve të thjeshta që bëhen me to.

Praktikë profesionale 13

Në klasën e 13-të, nëpërmjet kësaj lënde synohet që nxënësit të formojnë shprehi praktike në drejtim të shërbimit dhe riparimit të automobilave. Kjo fokusohet në sistemet e transmetimit të fuqisë së motorit në rrotat aktive, në sistemet e drejtimit, në sistemet e frenimit dhe të kontrollit të stabilitetit të mjetit gjatë lëvizjes së tij. Këto realizohen nëpërmjet praktikës që nxënësit zhvillojnë në firmat e ndryshme të riparimit të automobilave. Nxenesit aftesohen në riparimet xhenerike, motorrike, elektroauto, elektronike dhe diagnostikim të automobilave.